



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 116/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vima Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur-Marrëveshje kuadër*” me Nr. REF-79374-11-20-2020 me objekt: “Furnizimin me teste Serologjike për Analizator Abbot Architect i2000 ose ekuivalent për nevoja të QSUNT”, me fond limit 45,500,000 lekë pa tvsh e zhvilluar në datën 28.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues: Operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k
Adresa: Rruga “Siri Kodra”, Nr. 149, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 23.11.2020, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur-Marrëveshje kuadër*” me Nr. REF-79374-11-20-2020 me objekt: “*Furnizimin me teste Serologjike për Analizator Abbot Architect i2000 ose ekuivalent për nevoja të QSUNT*”, me fond limit 45,500,000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 28.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 28.12.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 01.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Biochem NRP Shpk	I kualifikuar	23,310,000.00
Pegasus Shpk	I kualifikuar	45,150,000.00
Farma Net Albania Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Evita Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Fedos Shpk	I skualifikuar	pa ofertë

II.5. Në datën 05.02.2021, operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k.

II.6. Me anë të shkresës nr.531/9 prot datë 24.02.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke vendosur pranimin e ankesës.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr.531/12 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.335/3 datë 05.03.2021, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se më datë 25.02.2021 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurë së prokurimit objekt ankimi me rezultatet si më poshtë vijon:

Biochem NRP Shpk	I skualifikuar	23,310,000.00
Pegasus Shpk	I kualifikuar	45,150,000.00
Farma Net Albania Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Evita Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Fedos Shpk	I skualifikuar	pa ofertë

II.7. Në datën 24.02.2021, operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 531/12 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.335/3 datë 05.03.2021, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pegasus” sh.p.k për kualifikim të padrejtë nga ana e autoritetit kontraktor të ofertës së operatorit ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k, nga shqyrtimi i dokumenteve që Komisioni i Prokurimit Publik disponon në lidhje me këtë procedurë prokurimi, u konstatua si vijon:

III.1.1. Në datën 01.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Biochem NRP Shpk	I kualifikuar	23,310,000.00
Pegasus Shpk	I kualifikuar	45,150,000.00
Farma Net Albania Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Evita Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Fedos Shpk	I skualifikuar	pa ofertë

III.1.3. Në datën 05.02.2021, operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k.

III.1.4. Me anë të shkresës nr.531/9 prot datë 24.02.2021 , autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke vendosur pranimin e ankesës.

III.1.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr.531/12 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.335/3 datë 05.03.2021, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se më datë 25.02.2021 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurë së prokurimit objekt ankimi me rezultatet si më poshtë vijon:

Biochem NRP Shpk	I skualifikuar	23,310,000.00
Pegasus Shpk	I kualifikuar	45,150,000.00
Farma Net Albania Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Evita Shpk	I skualifikuar	pa ofertë
Fedos Shpk	I skualifikuar	pa ofertë

III.1.6. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k është skualifikuar nga autoriteti kontraktor duke përmbushur qëllimin e tij në këtë procedurë prokurimi, ndaj dhe pretendimet e tij nuk do të merren në shqyrtim në themel nga KPP, pasi nuk ekziston më si objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pushojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur-Marrëveshje kuadër*” me Nr. REF-79374-11-20-2020 me objekt: “*Furnizimin me teste Serologjike për Analizator Abbot Architect i2000 ose ekuivalent për nevoja të QSUNT*”, me fond limit 45,500,000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 28.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 335 Protokolli; Datë 24.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri